



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC**

---

Numri i lëndës: 2020:180343

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04855622

**PPP. nr. 298/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC**- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit H.B nga Komuna Gllogoc, kundër debitorit M.Gj nga Komuna e Gllogocit, për shkak të lirimit të pronës së paluajtshme, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit Y.K, P.nr... të datës 24.11.2020, jashtë seancës me datën 30.10.2023 gjykata e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** prapësimi i debitorit M.Gj nga Komuna e Gllogocit, ushtruar kundër urdhërit të Përmbartuesit Privat Y.K, P.nr... të datës 24.11.2020, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit, që debitori të ia mundësoj kreditorit H.B shfrytëzimin dhe posedimin e paluajtshmërisë së cekur si në propozimin për përmbartim, ndërsa urdhëri i Përmbartuesit Privat Y.K, P. nr... i datës 24.11.2020 **mbetet në fuqi**.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat Y.K duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit penal P. nr. 600/2016 të datës 01.11.2019 i cili është i plotëfuqishëm, paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ndërsa në bazë të Nenit 24 par.1 të këtij ligji është dokument i përmbartueshem.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit me datën 10.12.2020 debitori ka paraqit prapësim, pas pranimit të urdhërit përmbartimor me datën 02.12.2020, me arsyetimin se: *në bazë të aktgjykimit të plotëfuqishëm P. nr. 600/16 të datës 01.11.2019 i vërtetuar nga Gjykata e Apelit, debitori është obliguar që kreditorit të ia mundësoj shfrytëzimin dhe posedimin e paluajtshmërisë në ZK... Komuna Gllogoc në vendin e quajtur... pronë e Kreditorit, i njëjti ka theksuar se pas plotëfuqishmërisë së Aktgjykimit debitori e ka liruar pronën kontestuese dhe se debitori ka qenë i lirë që të marr në posedim pronën por i njëjti as që ka provuar ta bëjë një gjë të tillë. Duke i propozuar gjykatës të aprovoj prapësimin në tërësi dhe të prish në tërësi Urdhërin përmbartimor P. nr... të datës 24.11.2020.*

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilin ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se: *prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe është jashtë afatit ligjor pasi që është paraqitur pasi që ka kaluar afati, sepse në fletë kthesë urdhëri përmbarues është pranuar me datën 02.12.2020 kurse ankesa është dorëzuar në postë në Glllogoc me datën 10.12.2020, pra ka kaluar afati prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhërit, i ka kundërshtuar edhe pretendimet e debitorit se kinse e ka liruar pronën pasi që kjo nuk qëndron sepse prona nuk është liruar nga sendet pasi që duhet të hiqet ndërtimi, i njëjti i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe të vërtetoj urdhërin përmbarimor P. Nr... të datës 24.11.2020.*

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit i datës 14.12.2020 është i pabazuar, pasi që me faktin se debitori është dënuar me Aktgjykim të plotëfuqishëm nga Gj.TH.P-Dega Glllogoc për shkak të veprës penale “*Uzurrpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme*” të parashikuar nga Neni 332 par. 1 të KPRK-së, ku përveç dënimit kryesor që i është shqiptuar të njëjtit i është urdhëruar edhe që të liroj pronën e uzurpuar duke i mundësuar tani kreditorit që të marr në shfrytëzim dhe posedim dhe atë në ngastrat kadastrale nr... Zona Kadastrale...-Komuna Glllogoc në vendin e quajtur... me sipërfaqe prej... ari e ... metra katror ku përfshihet “*duke liruar sipërfaqen prej... m2, shtruarje e asfaltit të vazhduar nga ngastra... pronë e M.Gj deri në ngastrën me nr... pronë e H.B, të cilën pjesë e shfrytëzon akoma edhe sot M.Gj për hyrje e dalje nga pika e karburantit “F...” si dhe pjesë tjera që ka të ndërtuar në paluajtshmerinë pronë e cila i takon kreditorit H.B, ndërsa nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se debitori nuk ka ndërmarr veprime që të liroj pronën e kreditorit ku vërehet se ka ndërtime në pjesët që është dashur të lirohen nga M.Gj sipas Aktgjykimit P.nr. 600/2016 i datës 01.11.2019, dhe se debitori nuk ka paraqit ndonjë provë që të argumentoj arsyetimin e tij në prapësim se “*debitori i e ka liruar pronën kontestuese dhe se debitori ka qenë i lirë që të marr në posedim pronën por i njëjti as që ka provuar ta bëjë një gjë të tillë*”. Poashtu prapësimi i debitorit i datës 10.12.2020 është i pasafatshëm, kjo pasi që në fletëkthesën që gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se propozimi për përmbarim dhe urdhëri për përmbarim është pranuar nga debitori me datën 02.12.2020 ndërsa prapësimin i njëjti e ka dorëzuar me datën 14.12.2020, çka nënkupton se ky prapësim është i pasafatshëm dhe i palejuar.*

Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke vendosur dhe atë duke u bazuar në Nenin 24 par. 1 të LPP-së që përcakton se “*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare*”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një aktgjykim i cili është plotëfuqishëm që nga data 10.03.2020 me të cilin është urdhëruar debitori që të liroj pronën e huaj konkretisht pronën e kreditorit H.B mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Kjo, shtuar edhe faktin se prapësimi është pasafatshëm dhe nuk është dorëzuar me kohë në gjykatë/postë. Me fletëkthesën që gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se, propozimi për përmbarim dhe urdhëri për përmbarim në të, është pranuar nga debitori me datën 02.12.2020 (e mërkure) ndërsa prapësimin debitori e ka dorëzuar në gjykatë (me postë) me datën 10.12.2020 ditë e enjte (prapësimi nga përmbaruesi privat është pranuar me datën 14.12.2023), e që data 10.12.2020 është një ditë pas afatit ligjor prej 7 ditëve për të paraqitur prapësimin (prej datës 03.12.2020 gjer me datën 09.12.2020 si dita e fundit e afatit për prapësim), kjo në kundërshtim me Nenin 70 të LPP-së që përcakton se “*Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhërit përmbarues*”.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të Nenit 73 par 3 të LPP-së kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glogoc  
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 298/20 i datës 30.10.2023**

**Gj y q t a r i  
Astrit Gashi**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbartimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.